



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

Për ndërmarrjen NewKo "Llamkos Steel" L.L.C, Vushtri, Rajoni i Mitrovicës
Numri i regjistrit: 70254965

Emrat alternativ:

Ndërmarrja e Re "Llamkos" Sh.P.K.

Novo Preduzece "Llamkos" D.O.O.

NewCo "Llamkos Steel" L.L.C.

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Nenit 39.3 dhe 39.6 të Rregullores 2001/6 mbi Organizatat Tregtare, Nenit 43.3 dhe 49 të Rregullores 2005/48 Mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre, Komisioni i Likuidimit vendosi që të publikoj ketë:

N J O F T I M

1) **Ka filluar Likuidimi i ndërmarrjes NewKo "Llamkos Steel" L.L.C. nga data 21 Dhjetor 2010**, në bazë të Vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të datës 15 dhe 16 Dhjetor 2010, i miratuar sipas Nenit 9.1 të Ligjit Nr. 03/L-067;

2) Sipas Rregullores 2005/49, çdo person (fizik dhe/ose juridik), i cili konsideron se është titullar i ndonjë të drejte pasurore kundër Ndërmarrjes NewKo "Llamkos" (në likuidim), nga pozita e tij si kreditor, si pretendues i ndonjë pasurie të paluajtshme apo i ndonjë të drejte tjetër, duhet ta dorëzoj në AKP, kërkesën (formularin) e tij së bashku me provat përkatëse mbi bazën e të cilave mund të vërtetohen pretendimet e tij;

3) Dokumentacioni i kompletuar në vështirim të pikës 2) të këtij Njoftimi, duhet të dorëzohet më së largu deri me datë **6 Mars 2011**, në adresën: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra e Koordinimit Rajonal, Rruga "Ilir Konushevc" nr. 8, 10.000 Prishtinë;

4) Në rast se kërkesa dhe dëshmitë për vërtetimin e saj, nuk paraqiten në kuadrin kohor dhe sipas udhëzimeve të dhëna si në pikat 2) dhe 3) të këtij Njoftimi, kreditorët dhe/ose kërkuesit eventual nuk do të jenë në gjendje të përfitojnë nga shpërndarja e të ardhurave nga procedura e likuidimit;

5) Kërkesat për kreditor, respektivisht formularët e kërkesave, mund të merret dhe duhet të dorëzohet (të kompletuar) në adresën: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra e Koordinimit Rajonal, Rr. Ilir Konushevc, 8. Prishtinë. Tel: +381 (0)38 500 400 / Fax: +381 (0)38 248 076;

6) Formularët për kërkesa, mund të merren gjithashtu edhe nga faqja e internetit, në adresën: www.pak-ks.org kurse për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih: "Si të paraqitni një kërkesë";

7) Lista e asetëve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Zyra Koordinimit Rajonal, Rr. Ilir Konushevc nr. 8, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyrë, pas datës 6 Mars 2011 deri në njoftimin e ardhshëm. Nëse keni arsye të pranueshme për pamundësinë e udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mësipërme për të aranzhuar mënyra tjera të qasjes;

8) Asetet do të ofrohen për shitje përmes tenderit, me oferta të mbyllura në datën e cila do të publikohet (jo me herët se 6 Mars 2011) duke përfshirë dhe faqen e internetit www.pak-ks.org